

BEQIR META

Instituti i Historisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
beqirmeta@hotmail.com

HASAN BELLO

Instituti i Historisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
hasanbello1@gmail.com

EMIGRACIONI SHQIPTAR PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**Abstrakt:**

Ky artikull ka si qëllim të trajtojë emigracionin shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore. Ai ka në fokus jo vetëm emigracionin ekonomik, por dhe atë politik, grupimet, partitë dhe fraksionet e ndryshme që u krijuan ndërmjet tyre lidhur me qëndrimin ndaj regjimit komunist. Një aspekt tjetër që trajtohet në këtë artikull është raporti i emigracionit politik shqiptar me qeveritë dhe shtetet respektive, si dhe bashkëpunimi i tyre me to kundër regjimit komunist. Politika e qeverisë shqiptare ndaj emigracionit ekonomik dhe politik gjatë viteve të diktaturës është një këndvështrim tjetër që jemi përpjekur të trajtojmë në këtë artikull.

Fjalë kyçe:

Emigracioni ekonomik, emigracioni politik, qeveria komuniste, SHBA, “Vatra”, Balli Kombëtar, Legaliteti, Blloku Kombëtar Independent.

Pas luftës diaspora shqiptare u zhvillua në rrethana të reja politike e shoqërore, që karakterizohej nga frenimi i emigracionit për shkak të izolimit të saj dhe ndërprerja e lidhjeve të emigracionit të vjetër me atdheun.

Në përgjithësi emigracioni shqiptar karakterizohej nga një gjendje ekonomiko-sociale e ulët. Përrjashtim bënte këtu emigracioni shqiptar në Amerikë dhe në Rumani. Në Amerikë, në grupin e emigrantëve që kishin

ardhur në fillim të shekullit, si rezultat i pagave relativisht më të mira se në vendet e tjera, ishte krijuar një shtresë emigrantësh që kishin vënë disa kapitale, kishin çelur ndonjë biznes të vogël apo të mesëm, ose ndonjë dyqan. Në brezin e ri të emigrantëve ishte rritur niveli arsimor dhe kishte specialistë të diplomuar në universitetet amerikane. Në vitin 1952 në radhët e tyre kishte vetëm 15% analfabetë. Në Rumani ishte krijuar një shtresë shqiptarësh të pasur që zotëronin shtëpi, dyqane, aksione në shoqëri të ndryshme etj. Kishte edhe një kategori dyqanxhinjsh të vegjël. Në vitet 1948-1950, pjesa më e madhe e emigracionit shqiptar në Rumani u godit nga reformat e qeverisë rumune. Ndërsa niveli ekonomik i emigracionit shqiptar në Turqi, Australi, Argjentinë, Francë etj., në përgjithësi ishte i ulët. Në Turqi vetëm një pjesë e emigrantëve të vendosur para Luftës së Dytë Botërore kishin mundur të stabilizonin gjendjen e tyre ekonomike. Emigrantët e ardhur para luftës dhe të vendosur në fshatra vazhduan të ruanin gjuhën dhe zakonet shqiptare. Ndërsa emigracioni i vendosur në qytete, kryesisht brezi i ri, po i humbiste ato.¹

Në Turqi ndodhej emigracioni më i madh shqiptar. Në përfundim të luftës ai llogaritej rreth 700-800 mijë banorë. Në vitet '50 u intensifikua politika jugosllave për dëbimin e popullsisë shqiptare nga trojet e veta.² Ky proces u ndihmua edhe nga qeveria turke. Për rrjedhojë, u rrit së tepërmi numri i shqiptarëve në Turqi. Procesin e emigrimit e nxisnin edhe disa faktorë të tjerë, si hapja e shkollave turke në Kosovë e në Maqedoni dhe nxitja e shqiptarëve që shkonin në to; ngatërrimi i qëllimshëm i fesë myslimane të shqiptarëve me kombësinë turke; vendosja e taksave më të rënda mbi bujqësinë në krahinën e Kosovës, në raport me zonat e tjera të Serbisë etj. Për pasojë, vala e emigrantëve shqiptarë që u vendos në Turqi në vitet '50-'60 ishte e fuqishme. Deri në vitin 1959 numri i tyre arrinte në 280 000 veta, ndërsa në periudhën 1953-1966 është llogaritur se nga Jugosllavia për në Turqi u shpërngulën 400 000 shqiptarë. Emigrantët e rinj u vendosën kryesisht në qytetet e

¹ Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Fondi MPJ (më tej: AMPJ), Viti (më tej V.) 1955, Dosja (më tej: D.) 401, fl. 22-27. Raport i legatës shqiptare në Romë, drejtuar MPJ-së, lidhur me gjendjen e emigracionit shqiptar, Romë, 30 dhjetor 1955.

² Për më tepër rreth valëve të emigracionit shqiptar në Turqi, shih: *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi (dokumente)*, përgatiti për botim Hakif Bajrami (Prishtinë: 1996).

Stambollit, të Izmirit, të Ankarasë etj. Legata shqiptare në Turqi llogariste se nga rreth 1 milion shqiptarët e Turqisë, 400 000 flisin mirë gjuhën shqipe, 370 000 dinin pak, ndërsa pjesa tjetër nuk e dinte fare atë.

Në jug të Italisë ruhej ende kolonia e vjetër arbëreshe me 250 000 banorë, e përqendruar në zonat përreth Kozencës, në Palermo, Katanzaro, Leçe, Kampobaso. Por, pas përfundimit të luftës, u shtua edhe emigrimi i arbëreshëve për në Amerikë. Këtu u krijua një komunitet i madh i ardhur nga Italia, i cili arrinte në 100 000 veta.

Emigracioni më aktiv dhe më i fuqishëm ishte ai i Amerikës. Këtu gjendeshin rreth 70 000 shqiptarë të emigruar që nga fillimi i shekullit e më vonë.³ Qendrat kryesore të emigracionit shqiptar në SHBA ishin: Nju-Jorku, Uashingtoni, Bostoni, Detroiti, San Francisko, Brixhporti etj. Në këtë vend kishte dhe rreth 5 000 emigrantë nga minoriteti grek në Shqipëri.

Koloni shqiptare të një rëndësie dhe numri më të vogël kishte në Rumani (15 000 veta) e përqendruar në Bukuresht, në Konstancë etj.; në Australi (4 000 veta) e përqendruar kryesisht në Brisbane, në Sheperpton, në Perth, në Northern Jork; Argjentinë (2 000 veta) e përqendruar në Buenos Aires, në Berisso, në Avellanoda, në La Plata; Bullgari (10 000 veta), që jetonin kryesisht në Sofje, në Plodviv etj. Oaze akoma më të vogla shqiptarësh kishte në Egjipt, në Republikën Arabe të Bashkuar, në Siri, në Itali, në Austri, në Rusi etj.⁴

Organizimi dhe orientimi politik

Fundi i luftës e gjeti emigracionin e vjetër shqiptar në një gjendje përgjithësisht të paorganizuar dhe të shkëputur nga atdheu. Qeveria komuniste ishte e izoluar në arenën ndërkombëtare dhe nuk vendosi lidhje me emigracionin e vjetër shqiptar. Kështu ajo autorizoi përfaqësitë jugosllave që të përfaqësonin interesat shqiptarë dhe të mbanin lidhje me diasporën shqiptare në një sërë vendesh. Disa vende kundërshtuan që t'ua njihnin këtë atribut përfaqësive jugosllave. Turqia, Greqia, Egjipti nuk pranuan që interesat e shqiptarëve t'i mbronin legatat jugosllave. Ndërsa

³ Beqir Meta, Erjon Dervishi, Hasan Bello, *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë (1912-1990)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2022), 224.

⁴ *AMPJ*, V. 1956, D. 398, fl. 11-15. Relacion i legatës shqiptare në Paris, drejtuar MPJ-së, lidhur me gjendjen e kolonive shqiptare në Francë, Argjentinë, Amerikë dhe Australi, Paris, janar 1956.

Departamenti i Shtetit i SHBA-së pranoi që autoritetet jugosllave të bënin shërbimin noterial në emër të Shqipërisë.⁵ Organizatat më të fuqishme patriotike gjendeshin në kolonitë shqiptare të SHBA-së, të cilat ishin më të organizuara se kolonitë në vendet e tjera. Federata Panshqiptare “Vatra”, e themeluar në vitin 1912 dhe organizata “Shqipëria e Lirë” e krijuar në vitin 1941 nga Kostë Çekrezi, ishin dy organizatat kryesore të emigracionit shqiptar në SHBA. “Vatra” kishte 50 degë në qytete të ndryshme të SHBA-së dhe 800 anëtarë, ndërsa “Shqipëria e Lirë” kishte 400 anëtarë. Gjatë viteve 1945-1949 të dyja organizatat,⁶ ndonëse përkrahnin qeverinë e Tiranës, zhvillonin një luftë të ashpër midis tyre.⁷ Debati dhe fërkimet midis tyre kishin filluar që gjatë luftës. “Shqipëria e Lirë” me në krye Çekrezin kishte dalë me parulla republikane dhe antizogiste, ndërsa “Vatra” dhe “Dielli” mbështetnin krijimin e një qeverie shqiptare zogiste në mërgim dhe krijimin e një fronti të përbashkët. Në mesin e vitit 1945, Kostë Çekrezi u largua nga posti i kryetarit dhe “Shqipëria e Lirë” ndryshoi orientimin politik, duke u shndërruar në një organizatë të majtë që mbështeste qeverinë komuniste të Shqipërisë.⁸

Në Argjentinë deri në vitin 1944 ekzistonte një shoqëri e emigrantëve shqiptarë me emrin “Shpresa”. Më pas u shkëput një grup që formoi shoqërinë “Skënderbeu”, që ishte nën influencën e zogistëve, ndërsa pjesa tjetër u shndërrua në një degë të “Shqipërisë së Lirë”. Në Australi ekzistonin dy shoqëri kryesore shqiptare.

Pas luftës, shqiptarët e Rumanisë u përpoqën të krijonin një shoqëri ku të bënin pjesë të gjithë emigrantët shqiptarë. Por divergjencat dhe përçarjet që ekzistonin këtu, tashmë filluan të merrnin ngjyra politike. Në vitin 1953, me një vendim arbitrar, autoritetet rumune e ndaluan organizatën e fundit shqiptare në Rumani. Agjentët e qeverisë konfiskuan

⁵ *Po aty*, V. 1948, D.B/I-8, nr. 61, fl. 5. Letër e legatës shqiptare në Beograd, drejtuar MPJ-së, Beograd, 2 korrik 1948.

⁶ *Po aty*, V. 1945, D. 61, fl. 1-2. Letër e Kostandin Çekrezit, drejtuar Enver Hoxhës, ku e informon për përkrahjen që organizata “Shqipëria e Lirë” do t’i jepte qeverisë shqiptare dhe se në bashkëpunim me “Vatrën” do të kërkonte njohjen e saj nga SHBA-ja, Arlington, 1945.

⁷ *Po aty*, fl. 34-36. Letër drejtuar Hysni Kapos në New York, lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur ndaj Kostë Çekrezit, Fan Nolit dhe Qerim Panaritit, New York, 1945.

⁸ *Po aty*, V. 1949, D. 286, fl. 16. Promemorie e ministrit të Punëve të Jashtme Hysni Kapo, lidhur me emigracionin shqiptar në SHBA dhe problematikat e shfaqura në raport me qeverinë shqiptare, Tiranë, 7 shtator 1947.

gjithë pasuritë e shoqatave shqiptare, duke përfshirë libraritë, arkivat, kostumet kombëtare dhe instrumentet muzikore.

Një grup i vogël shqiptarësh prej 1 000 vetash jetonte në Francë. Edhe ai ishte i përçarë dhe në të ishin krijuar dy komitete; në njërin kishin aderuar emigrantë anëtarë të Partisë Komuniste Franceze ose punëtorë të varfër, në tjetrin elementë antikomunistë. Më vonë këto komitete u shthurën dhe kolonia e Francës nuk pati ndonjë organizim të qëndrueshëm.

Në vitet e para pas luftës, emigracioni shqiptar në Turqi i kishte shkëputur lidhjet me atdheun. Qeveria shqiptare nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Turqinë. Mbrojtjen e interesave shqiptarë dhe trajtimin e problemeve të emigracionit shqiptar në këtë vend gjatë viteve 1945-1948 ajo ia kishte lënë në dorë përfaqësisë jugosllave. Këtë të drejtë qeveria shqiptare ua kishte akorduar përfaqësive jugosllave edhe në Amerikë, Greqi, Egjipt, e në ndonjë vend tjetër, duke u krijuar terren atyre që të vepronin në radhët e emigracionit shqiptar. Por qeveria turke nuk pranoi që legata jugosllave në Ankara të trajtonte problemet e emigracionit shqiptar dhe të mbronte interesat e shqiptarëve. Turqia ishte i vetmi vend që mbante këtë qëndrim. Ajo vazhdoi të njohë si përfaqësi legjitime kryekonsullatën mbretërore të Shqipërisë, të caktuar nga qeveria e Zogut.

Pas luftës veprimtaria politike e patriotike e diasporës shqiptare ishte në rënie. Ajo tashmë nuk ishte aq intensive dhe efektive sa ç'kishte qenë gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore. Arsyet ishin të ndryshme, si: izolimi i diasporës nga atdheu, predominimi i brezave të rinj që nuk kishin lindur në Shqipëri, humbja e gjuhës dhe mungesat në edukatën kombëtare, përçarjet politike, organizimi i dobët etj. Për një periudhë të gjatë kolonia më aktive ishte ajo e SHBA-së, ndërsa më vonë, me fillimin e viteve '60, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me Turqinë, u shtua edhe aktiviteti i kolonisë shqiptare të Turqisë.

Në përfundim të luftës emigracioni i vjetër shqiptar në shumë shtete të botës dhe kryesisht në Amerikë zhvilloi një aktivitet të ngjeshur politik e propagandistik për pranimin e Shqipërisë në Konferencën e San Franciskos dhe në OKB, për njohjen e qeverisë shqiptare dhe për mbrojtjen e integritetit territorial të vendit nga pretendimet aneksioniste greke. Organizata "Shqipëria e Lirë" në gusht të vitit 1944 i kërkoi qeverisë amerikane që të njihte qeverinë e Frontit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë. Në shtator të këtij viti këtë kërkesë e mbështeti edhe "Vatra".

Në mars të vitit 1945, “Shqipëria e Lirë” vendosi t’i jepte përkrahje pa rezervë dhe pa kushte qeverisë së Tiranës.⁹

Në vitin 1945 në Amerikë u krijua një Komision për Mbrojtjen e Kufijve të Shqipërisë i kryesuar nga Fan Noli. Për të ndihmuar aktivitetin e tij u mblodhën 20 000 dollarë. Komisioni bëri një punë të madhe për të luftuar propagandën greke në Amerikë dhe ndërhyri pranë shumë senatorëve e personaliteteve amerikane për t’ua bërë të qartë se pretendimet greke ishin të pathemelta. Komiteti botoi një memorandum të përgatitur nga Noli me titull “Shqipëria që nga viti 1939”. Në shkurt të këtij viti F. Noli u dërgoi një letër Ruzveltit, Çerçillit e Stalinit, në të cilën kërkonte njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare. Ai angazhoi në këtë aksion edhe Sinodin e Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës. Në mars të vitit 1946 ai shkoi në Uashington, ku bisedoi me personalitetet amerikane për pranimin e Shqipërisë në OKB dhe për çështjen e pretendimeve greke ndaj Shqipërisë së Jugut. Noli bisedoi me kryetarin e delegacionit amerikan në OKB, Herschel Johnson, të cilit i kërkoi që qeveria e SHBA-së të mbështeste kërkesën shqiptare për anëtarësim në Kombet e Bashkuara dhe i shpjegoi absurditetin e pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut. Ai bisedoi edhe me kryetarin e delegacionit britanik në Nju-Jork, i cili premtoi se po të zgjidheshin mosmarrëveshjet, qeveria britanike do të përkrahte pranimin e Shqipërisë në OKB. Noli u takua edhe me përfaqësues të tjerë të Fuqive të Mëdha në Nju-Jork, si dhe me 10 nga 11 anëtarët e Këshillit të Sigurimit. Në qershor të këtij viti, me cilësinë e kryetarit të kishave shqiptare në Amerikën e Veriut, Noli i dërgoi një telegram Sekretarit të Departamentit të Shtetit, Xhejms Bërns, i cili ndodhej në Paris në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Jashtëm për shqyrtimin e Traktateve të Paqes. Ai i cilësoi absurde pretendimet greke ndaj Shqipërisë së Jugut, duke vënë në dukje se karakteri shqiptar i këtij rajoni ishte njohur edhe më parë nga disa komisione hetimore ndërkombëtare në vend dhe në bazë të këtyre fakteve rajoni i qe njohur Shqipërisë nga traktatet e konferencat e mëparshme ndërkombëtare. Para mbledhjes së Konferencës së Paqes, më 3 mars 1946, shqiptarët e Amerikës zhvilluan një miting të madh në kryekishën e Shën Gjergjit, ku u protestua kundër pretendimeve aneksioniste greke, rezolutës së

⁹ Për më gjerë një informacion i detajuar është botuar në: *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1945-1958 (dokumente historike)*, përgatitur nga B. Meta, H. Bello, vëll. II (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2022).

senatorit Peper dhe propagandës antishqiptare e progreke që po zhvillonte në atë kohë në Amerikë peshkopi P. Kotoko. Me anë të një rezolute, mitingu i kërkoi qeverisë amerikane që të lejonte një përfaqësues të qeverisë shqiptare të vinte në Amerikë për të kundërshtuar pretendimet dhe propagandën greke.¹⁰

Duke parë pozitën e vështirë të Shqipërisë, në janar të vitit 1947, Kostë Çekrezi i propozoi F. Nolit që të dyja organizatat e shqiptarëve të Amerikës të bashkëpunonin për të mbrojtur Shqipërinë.¹¹ Noli nuk e pranoi këtë propozim. Madje, i nxitur nga mosmarrëveshjet e vjetra që kishte pasur me të, bashkë me Qerim Panaritin, letrën e Çekrezit, e cila kishte pozicion kritik ndaj qeverisë së Tiranës, ia dërguan asaj. Udhëheqja komuniste e përdori këtë letër për t'i armiqësuar më shumë të dyja palët. Pas kësaj, Çekrezi u dërgoi një letër të hapur anëtarëve të “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë”, që ata të gjallëronin aktivitetin e tyre, i cili ishte në nivel të ulët për të korrigjuar politikën e gabuar të qeverisë komuniste ndaj SHBA-së dhe të bëheshin urë për afrimin midis Shqipërisë e SHBA-së, me qëllim që Shqipëria të pranohej në organizmat ndërkombëtarë dhe të shmangej rreziku i copëtimit të saj.¹²

Zërin e tyre në mbrojtje të interesave të Shqipërisë e ngritën edhe koloni e organizata të tjera shqiptare, si: shoqëria “Skënderbeu” në Argjentinë, Bashkësia Shqiptare në Egjipt, Organizata Antifashiste Shqiptare në Rumani etj.

Në vitet e para pas përfundimit të luftës, qeveria e Tiranës gëzonte një mbështetje relativisht të gjerë në emigracionin shqiptar, ndonëse kishte edhe segmente të ndryshme të diasporës që tregoheshin indiferente, mosbesuese e armiqësore ndaj saj. Mbështetja më e madhe asaj iu dha nga diaspora shqiptare e Amerikës, si nga “Shqipëria e Lirë” me orientim të majtë, ashtu dhe nga “Vatra” e Kisha Ortodokse Shqiptare e Amerikës, që e shihnin mbështetjen e qeverisë së Tiranës në funksion të interesave kombëtarë. Prandaj ato i dhanë asaj një mbështetje të gjerë politike, propagandistike dhe ekonomike. Udhëheqësi kryesor i emigracionit shqiptar të Amerikës, Fan Noli, të paktën deri në vitin 1946,

¹⁰ Meta, Dervishi, Bello, *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1912-1990*, 191-204.

¹¹ *AMPJ*, V. 1947, D.159, fl. 17-18/1. Letër e Kostandin Çekrezit, drejtuar anëtarëve të organizatave “Shqipëria e Lirë” dhe “Vatra”, lidhur me qëndrimin e SHBA-së ndaj çështjes shqiptare dhe nevojën për bashkëpunim, Arlington, 15 maj 1947.

¹² *Po aty*, fl. 1-4. Letër e delegacionit shqiptar në New York, drejtuar MPJ-së, lidhur me emigracionin shqiptar në SHBA dhe organizatën “Vatra”, New York, 23 tetor 1947.

ushqente simpati për qeverinë komuniste. Ndonëse refuzoi ftesën e Enver Hoxhës që të kandidonte në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1945 në favor të Frontit Demokratik, ai pranoi të vihej në shërbim të fushatës elektorale të komunistëve dhe që emri i tij të përdorej për të fituar vota në favor të Partisë Komuniste.¹³ Pas largimit të Misionit amerikan nga Shqipëria, Noli dhe udhëheqës të tjerë të diasporës së Amerikës u tronditën seriozisht. Për një moment ata rrëshqitën në një pozitë të gabuar, e cila ishte e afërt me propagandën e Enver Hoxhës. Këmbënguljen amerikane për njohjen e marrëveshjeve dhe të traktateve të mëparshme ata e cilësuan si një pretekst dhe jo si një arsye reale për mosvendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Mbështetja gjerësisht e qeverisë komuniste nga “Vatra” krijoi pakënaqësi në Departamentin e Shtetit. Për këtë arsye miq të shquar të Shqipërisë, si p.sh. ish-diplomati amerikan në Tiranë, Charles C. Hart, u përpoqën t’i bindin drejtuesit e diasporës shqiptare se po vepronin në drejtimin e gabuar dhe në një terren të rrezikshëm, pasi ata nuk e dinin mirë gjendjen e marrëdhënieve midis qeverisë shqiptare dhe asaj amerikane, kështu që i këshilluan që të mbronin vetëm paprekshmërinë e kufijve të Shqipërisë, sepse mosmarrëveshjet e tjera midis dy qeverive ishin delikate dhe të ngatërruara.¹⁴

Më pas situata filloi të ndryshojë. Noli dhe “Vatra” filluan të rezervoheshin disi në qëndrimet ndaj qeverisë komuniste, ndërsa njëri nga personalitetet e tjera të diasporës, Kostë Çekrezi, kishte fituar armiqësinë e plotë të qeverisë komuniste. Në vitin 1946, marrëdhëniet midis qeverisë shqiptare dhe asaj amerikane u keqësuan. Qeveria e Tiranës ngulte këmbë në mosnjohjen e marrëveshjeve të nënshkruara midis të dyja vendeve para luftës. Enver Hoxha u përpoq të siguronte mbështetjen e emigracionit shqiptar të Amerikës, duke e paraqitur politikën e qeverisë së tij si një qëndrim parimor që u shërbente interesave kombëtarë.¹⁵ Noli dhe udhëheqës të tjerë të diasporës në Amerikë i sugjeruan qeverisë komuniste që të përmirësonte marrëdhëniet me SHBA-në dhe me fuqitë e tjera perëndimore, të njihte traktatet që

¹³ *Po aty*, V. 1945, D. 61, fl. 3. Letër e Fan Nolit, drejtuar Enver Hoxhës, lidhur me arsyet pse nuk mund të kandidonte në Shqipëri dhe ku i premtonte mbështetjen që i jepte regjimit komunist, Boston, 3 tetor 1945.

¹⁴ *Po aty*, fl. 56. Letër e Charles Hart-it, drejtuar John Nasse-s, ku analizon mënyrën se si duhej vepruar për të mbrojtur çështjen shqiptare, 11 gusht 1946.

¹⁵ *Po aty*, fl. 72. Letër e Enver Hoxhës, drejtuar Fan Nolit dhe John Nasse-s, lidhur me refuzimin e pranimit të Shqipërisë në OKB (pa datë).

shteti shqiptar kishte nënshkruar me SHBA-në, duke shpjeguar se kjo ishte rruga e vetme e mbrojtjes së interesave kombëtarë dhe e prosperitetit të vendit. Në mars të vitit 1946, Noli i dërgoi një telegram Enver Hoxhës, në të cilin theksonte: “Unë besoj që tani ç’do vonesë do të paragjykojë çështjen tonë. Duke marrë parasysh shqyrtimin e afërt në OKB të kërkesës së Shqipërisë për anëtarësim dhe propagandën intensive greke mbi “Epirin e Veriut”, unë sugjeroj të pranohen menjëherë traktatet në fjalë. Ky pranim do të sjellë automatikisht njohjen amerikane, do të zhdukë pengesat për pranimin në OKB dhe do të na lehtësojë punën e mbrojtjes me sukses të integritetit tokësor të Shqipërisë”.¹⁶

Mirëpo qeveria e Tiranës nuk i përfilli këto kërkesa e sugjerime të diasporës, madje ato do të çonin në ftohjen e marrëdhënieve me të. Krisja e parë serioze e marrëdhënieve të F. Nolit me udhëheqjen komuniste ndodhi në shtator të vitit 1946, gjatë vizitës së Tuk Jakovës në Amerikë.¹⁷ Zyrtari i lartë i Tiranës shfaq hapur mosbesimin ndaj Nolit dhe “Vatrës” dhe u përzie në mosmarrëveshjet e “Vatrës” me “Shqipërinë e Lirë”, duke mbajtur anën e kësaj të fundit. Më pas, mosmarrëveshjet e “Vatrës” me qeverinë e Tiranës u shtuan. Autoritetet shqiptare penguan dërgimin e ndihmave në Shqipëri prej organizatës humanitare Albanian Relief Fund dhe Komitetit Vullnetar Shqiptar, i cili qe krijuar për të ndihmuar emigrantët që të dërgonin ndihma për familjet e tyre. Megjithëse, për arsye të koniunkturës politike, dërgimi i ndihmave në Shqipëri ishte i vështirë, “Vatra” organizoi aksionin e mbledhjes së ndihmave dhe fushata u prit me entuziazëm nga shqiptarët e Amerikës.¹⁸ Në Shqipëri u dërgua miell, veshmbathje etj., për zonat e prekura nga uria. Por ky aksion shkaktoi reagimin negativ të udhëheqjes komuniste, e cila, e nisur nga motive politike, pa marrë parasysh se vendi kishte nevoja urgjente për ushqime, medikamente etj., dha urdhër që të kundërshtohet kjo fushatë. Hysni Kapo i shkruante Kahreman Yllit: “Fushata, kuptohet që bëhet me pretekst se në Shqipëri ka uri. Këto janë parulla të reaksionit.

¹⁶ *Po aty*, fl. 2. Radiogram i Hysni Kapos nga Beogradi, drejtuar MPJ-së, lidhur me një telegram të Fan Nolit, mbi çështjen e anëtarësimit të Shqipërisë në OKB, Beograd, 25 mars 1946.

¹⁷ *Po aty*, fl. 66-69. Telegram i Fan Nolit, drejtuar Enver Hoxhës, lidhur me qëndrimin e kryetarit të delegacionit shqiptar në SHBA Tuk Jakova, Boston, 30 shtator 1946.

¹⁸ *Po aty*, V. 1947, D.158, fl.26. Letër e drejtuesit të gazetës “Dielli”, Qerim Panariti, drejtuar Enver Hoxhës, lidhur me fushatën e “Vatrës” për të mbledhur ndihma për popullin shqiptar, Boston, 1947.

Thuaju haptazi se Shqipëria nuk ndihmohet me gjëra qesharake dhe të marrin shembull nga jugosllavët se si vepronë për vendin e tyre. Shqiptarët nuk kanë bërë asgjë për Shqipërinë. Lodra si kjo e “Vatrës” është vetëm për të fituar kredi në Departamentin e Shtetit, për interesat e tyre”. Pengimi i ndihmave ngjalli habi dhe indinjatë në emigracionin e Amerikës.

Në vitin 1950 pakënaqësia e emigrantëve të Amerikës u shtua, pasi qeveria shqiptare u vuri taksa të rënda doganore ndihmave që ata dërgonin në Shqipëri. Meqë të afërmit e tyre në Shqipëri nuk mund t’i paguanin këto taksa, sendet e dërguara në Trieste u kthyen mbrapsht në Amerikë, ndërsa një pjesë e ndihmave të “Vatrës” mbetën të bllokuara për muaj të tërë në këtë port.¹⁹

Në të vërtetë në marrëdhëniet me diasporën qeveria komuniste kishte synime të tjera. Ajo kishte përcaktuar si objektiv kryesor mobilizimin e kolonisë në luftë kundër ballistëve e kundërshtarëve të tjerë politikë dhe, së dyti, grumbullimin e shumave monetare që të kontrolloheshin vetëm prej saj. Pikërisht për këtë arsye ajo iu përvesh punës për të vënë nën kontroll dy organizatat kryesore të emigracionit në Amerikë dhe gjetkë.²⁰

Ndonëse në aparençë misionarët e qeverisë shqiptare që shkonin në Amerikë tregoheshin neutralë, në prapaskenë ata mbështetnin organizatën “Shqipëria e Lirë”, e cila dukej se ishte më pranë tyre dhe më e lehtë për t’u vënë nën kontroll. Madje, ata i dhanë asaj subvencione të fshehta për të zhvilluar propagandë kundër kundërshtarëve të regjimit komunist. Tirana, ndonëse propagandonte bashkimin e diasporës, në të vërtetë i trembej dhe nuk e dëshironte atë. B. Shtylla, në maj të vitit 1949, i shkruante Ministrisë së Punëve të Jashtme se bashkimi i emigracionit në Amerikë ishte “i pamundur, por edhe i pakëshillueshëm sepse, po të bashkohen, në një kohë të shkurtër, efektivisht organizata e vetme do të bjerë në dorë të Fan Nolit e të Qerimit (Panaritit) i cili nuk na e do

¹⁹ *Po aty*, V. 1950, D.249, fl.29. Letër e M. Kokalarit, drejtuar Fan Nolit, lidhur me pengesat që kishte hasur për dërgimin në Shqipëri të ndihmave të mbledhura nga “Vatra”, New York, 5 janar 1950.

²⁰ *Po aty*, fl. 11-13. Udhëzime të MPJ-së, drejtuar legatës shqiptare në Paris, lidhur me qëndrimin që duhej të mbahej ndaj kolonisë shqiptare në SHBA dhe Federatës “Vatra”, Tiranë, 11 qershor 1950.

shëndetin dhe do të kthehen kundër nesh”.²¹ Në këto rrethana qeveria e Tiranës vijoi përpjekjet për t’i nxitur të dyja organizatat që të ndiqnin një vijë politike në favor të regjimit në Shqipëri, të popullarizonin politikën e tij dhe të ishin në një front të përbashkët kundër emigracionit politik.

Regjimi pati disa suksese të dukshme në mobilizimin e udhëheqësve të diasporës në fushatën kundër ballistëve e zogistëve. Kështu për një kohë të gjatë “Liria”, “Dielli” dhe gazeta të tjera zhvilluan një propagandë intensive kundër tyre. Madje në dhjetor të vitit 1949 në këtë fushatë u inkuadrua edhe Noli, të cilin zyrtarët komunistë e shtynë, direkt dhe indirekt, që të botonte në gazetën “Dielli” një deklaratë kundër ballistëve. Ajo u mbështet edhe nga deklaratat analoge të kryetarëve të “Shqipërisë së Lirë” e “Vatrës”, respektivisht Xhon Nasse e Dhimitër Luarasi.²²

Në vitet ’50 Tirana zyrtare vijoi përpjekjet që t’i bashkonte të dyja organizatat e emigracionit shqiptar të Amerikës në një front kundër kundërshtarëve politikë të regjimit. Në këtë kuadër nga diplomatët shqiptarë u bënë përpjekje për ta lidhur organizatën “Shqipëria e Lirë” me Partinë Komuniste Amerikane, me qëllim që ajo të fitonte një mbështetje më të madhe politike e materiale. Këto përpjekje u bënë edhe ndaj organizatave të emigracionit shqiptar në disa vende të tjera, si në Argjentinë, Australi, Francë, Itali etj. Ndërkohë filloi goditja e hapur publike e editorit të “Diellit”, Qerim Panariti, i cili kishte botuar disa artikuj me sens kritik kundër regjimit.²³ Tashmë regjimi po zbatonte hapur metodat e tij të luftës së klasave edhe në diasporë. Po në këtë kuadër u intensifikuan përpjekjet për të vendosur elementë prokomunistë në krye të organizatave patriotike. Noli po kontrollohej me kujdes. Mirëpo fushata kundër Qerim Panaritit dështoi, për arsye të mbështetjes së dobët që kishte regjimi brenda “Vatrës”, mbështetje e cila sa vinte e po binte.

²¹ *Po aty*, V. 1949, D. 211, fl. 66-79. Raport i ministrit shqiptar në Paris, Behar Shtylla, drejtuar MPJ-së, lidhur me koloninë shqiptare në SHBA dhe veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar kundër regjimit komunist, Paris, 27 maj 1949.

²² *Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit* (më tej: *AIDSSH*), D. 3. Deklaratë e Fan Nolit ku sulmon Ballin Kombëtar dhe bën thirrje për të mbështetur regjimin komunist, Boston, 15 dhjetor 1949.

²³ *AMPJ*, V. 1950, D. 249, fl. 13. Letër e ministrit shqiptar në Francë, Behar Shtylla, drejtuar MPJ-së, lidhur me udhëzimet e saj për punën me emigracionin shqiptar në SHBA dhe demaskimin e drejtuesit të gazetës “Dielli” Qerim Panariti, Paris, 28 korrik 1950.

Në vitin 1951, si rezultat i diversionit që po zhvillonte Patrikana e Stambollit kundër KOASH-it të Amerikës, u zhvillua një betejë e vërtetë midis forcave patriotike dhe elementëve grekomanë.²⁴ Këtë herë “Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë” u ndodhën në të njëjtën anë të barrikadës, duke u vënë në mbrojtje të Peshkopatës. Kjo gjendje i rriti shanset për bashkimin midis tyre. Por këtë afrim e pengoi ndërhyrja e qeverisë së Tiranës, e cila u kërkoi njerëzve të saj në organizatën “Shqipëria e Lirë” që bashkimin ta bënin vetëm mbi bazën e platformës së përcaktuar nga Tirana, e cila konsistonte në përkrahjen e propagandimin e politikave të regjimit komunist dhe në luftën kundër kundërshtarëve politikë në diasporë. Në këtë mënyrë, udhëheqja komuniste pengoi bashkimin e “Vatrës” me “Shqipërinë e Lirë”, i planifikuar për t’u realizuar në korrik të vitit 1951. Nga ana tjetër, emisarët e Patrikanës Greke të Stambollit u përpoqën të armiqësonin Nolin me Departamentin e Shtetit, duke e akuzuar atë se donte ta vendoste kishën ortodokse në Amerikë nën kontrollin dhe në shërbim të regjimit komunist të Tiranës.²⁵

Ndër pikat e nxehta të marrëdhënieve të qeverisë komuniste me diasporën në vitet ’50 vazhdoi të mbetej politika e saj e riatdhesimeve. Autoritetet shqiptare kishin refuzuar qindra kërkesa të emigrantëve ekonomikë shqiptarë për t’u riatdhesuar ose për të vizituar Shqipërinë. Një qëndrim i tillë u mbajt edhe ndaj Nënë Terezës. Deri në vitin 1989 asaj iu mohua viza e hyrjes në Shqipëri.

Një politikë e tillë izolacioniste ndaj emigracionit pati sigurisht një kosto të rëndë në planin e interesave kombëtarë. Ajo thelloi hendekun midis diasporës dhe atdheut, në një kohë që brezat e rinj në radhët e diasporës kishin nevojë për kontakte me atdheun, pasi nuk dinin gjuhën dhe ndjenjat për mëmëdheun rrezikoheshin të zbeheshin, për shkak të përçarjeve dhe propagandës së qarqeve antishqiptare.

²⁴ *Po aty*, V. 1951, D. 253, fl. 8. Letër e ministrit shqiptar në Francë, Behar Shtylla, drejtuar Fan Nolit, lidhur me një letër të Koço Tashkos dhe përpjekjeve që ai po bënte kundër të dërguarit të Athinagorës priftit Marko Lipa, Paris, 24 mars 1951.

²⁵ *Mbreti Zog dhe Fan Noli në dosjet e Sigurimit të Shtetit*, përgatiti për botim Hasan Bello (Tiranë: Instituti i Historisë, ASA, 2021), 220.

Marrëdhëniet e qeverisë komuniste me diasporën në vitet '60 dhe ndërhyrja e huaj në diasporën shqiptare

Në vitin 1960 emigrantët politikë në përbërjen e organizatës “Vatra” u shtuan, madje ata morën edhe drejtimin e degës së Nju-Jorkut, e cila ishte dega më e fuqishme e saj.²⁶ Në këto rrethana qeveria e Tiranës vendosi të godiste hapur “Vatrën”. Sulmi filloi me një thirrje të Komitetit të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar drejtuar anëtarëve të “Vatrës”, e cila e denonconte atë si organizatë “tradhtarë”. Thirrja përfundonte: “Largohuni nga “Vatra”, hidheni në shportë lëverën e saj “Dielli”. O me Shqipërinë dhe me popullin shqiptar, o me “Vatrën” dhe me tradhtinë”.

Pas këtyre ngjarjeve, Misioni i Shqipërisë në OKB dhe Ministria e Jashtme i shtuan përpjekjet për të shpërbërë “Vatrën”, ose për të krijuar një fraksion brenda saj që të mbështeste regjimin. Por këta objektiva nuk u arritën. “Vatra” e “Dielli” vijuan të qëndronin në opozitë me regjimin. Madje në fillim të viteve '60 po dukeshin lëkundje të reja edhe në organizatën “Shqipëria e Lirë”, gazeta e së cilës filloi të shtronte sërish çështjen e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë e SHBA-së.²⁷

Duke përfutur nga përçarja dhe izolimi i emigracionit shqiptar nga politikat ekstremiste të qeverisë komuniste, nga ashpërsimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me Perëndimin dhe veçanërisht me SHBA-në, organizatat vorio-epirote dhe zbulimet (agjencitë e inteligjencës) e huaja u përpoqën të penetronin në emigracionin shqiptar. Më të dukshme këto përpjekje ishin në SHBA, Australi, Turqi, Argjentinë dhe Egjipt.

Një ballafaqim i ashpër u zhvillua për Kishën Ortodokse Shqiptare në diasporë, i cili ishte diku i nëndheshëm dhe diku i hapur. Qarqet patriotike shqiptare me në krye Nolin u përpoqën të ruanin karakterin kombëtar dhe pavarësinë e KOASH-it. Përballë tyre qëndronte Patrikana

²⁶ AMPJ, V. 1960, D. 536/4, fl. 33. Njoftim i përfaqësuesit të përhershëm të Shqipërisë në OKB, Reis Malile, drejtuar MPJ-së, lidhur me anëtarësimin e disa kundërshtarëve të regjimit komunist në Federatën “Vatra”, New York, 1 mars 1960.

²⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (AP)-Strukturë (Str), Viti (më tej: V.) 1960, Dosja (më tej: D.) 519, fl. 2-6. Relacioni i të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në OKB, Kleanthi Zoto, drejtuar MPJ-së, lidhur me koloninë shqiptare në SHBA, New York, 1 qershor 1960.

Greke e Stambollit, kisha greke në Amerikë dhe në shtete të tjera, qeveria greke me agjencitë e saj diplomatike dhe të inteligjencës, si dhe organizatat vorio-epirote, të cilat u përpoqën të merrnin në dorë drejtimin e kishave ortodokse shqiptare në vende të ndryshme nëpërmjet klerikëve dhe elementëve grekomanë, të dobësonin karakterin e saj kombëtar dhe ta kthenin në një rezervë dhe mbështetje të politikës greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Ndërhyrja, diferencimi politik dhe lufta që po zhvillonte qeveria komuniste ndaj kundërshtarëve të saj politikë në diasporë e kishte dobësuar qëndresën e qarqeve patriotike, pasi kishte krijuar një përçarje të thellë në diasporë.²⁸

Si rezultat i politikave ekstreme të regjimit komunist, në mesin e viteve '60, emigracioni shqiptar u izolua edhe më tej nga atdheu. Përveç të tjerash, kjo u krijoi mundësi politikës dhe kishës greke të intensifikonin veprimtarinë ndaj ortodoksëve shqiptarë. Qeveria shqiptare i vlerësonte rreziqet që vinin nga penetrimi i grekëve në kishat shqiptare dhe theksonte se, në një rast të tillë, grekët do të penetronin në të gjitha kolonitë shqiptare në vende të ndryshme dhe do të bënin më shumë zhurmë me deklaratat e peticione në organizmat ndërkombëtarë, sidomos në OKB, për parashtrimin e pretendimeve të tyre territoriale. Por interesat e saj të ngushtë politikë dhe vija e saj e ngurtë ideologjike po çonin në drejtimin e kundërt, në dobësimin e institucioneve kombëtare në diasporën shqiptare.²⁹

Më 13 mars 1965, vdiq F. Noli. Vdekja e tij, siç pritej, e ndezi luftën politike. Beteja u zhvillua për mënyrën se si do të zhvillohej ceremonia mortore, ku do të varrosej trupi i Nolit, kujt do t'i kalonte trashëgimia e tij etj. Por në esencë ajo kishte shqetësimin se kush do ta merrte në dorë Peshkopatën dhe drejtimin e komunitetit shqiptar të Amerikës. Lufta që e ashpër, por rezultatet e saj ishin të balancuara. Komunistët dhe njerëzit e tyre arritën të vendosnin në krye të kishës njeriun e pëlqyer prej tyre, Stefan Laskon,³⁰ ata penguan emigrantët

²⁸ *Po aty*, F. 14/AP STR, V. 1962, D. 524, fl. 37-42. Relacion i MPJ-së "Mbi gjendjen e emigracionit reaksionar dhe ekonomik shqiptar në vendet e huaja dhe detyrat tona për të ardhmen" drejtuar KQ të PPSH-së, Tiranë, 1962.

²⁹ Raport i Drejtorisë së Parë të MPB-së mbi gjendjen e emigracionit ekonomik shqiptar dhe veprimtarinë që duhej të zhvillohej kundrejt tij, Tiranë, 1965. *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1959-1971 (dokumente historike)*, përgatitën për botim B. Meta, H. Bello, vëll. III (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri", 2022, 530-555.

³⁰ Meta, Dervishi, Bello, *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1912-1990*, 318.

politikë të mbanin fjalime në funeralin e Nolit dhe siguruan që biblioteka e tij t'i lihej trashëgim Universitetit të Tiranës. Ndërsa kundërshtarët e tyre bllokuan përcjelljen e trupit të Nolit për në Shqipëri dhe ndaluan leximin e telegramit të Kryeministrit të Shqipërisë, Mehmet Shehu, në ceremoninë mortore. Në këto ngjarje spikati ndërhyrja e hapur e Misionit të Shqipërisë në OKB. Lufta politike për kryesinë e kishës vijoi edhe më tej, për shkak se grupi antikomunist i drejtuar nga Antoni Athanas nuk e pranoi emërimin e Laskos si kryepeshkop të Kishës Shqiptare në Amerikë. Ngjarjet në Peshkopatë vunë përballë edhe njëherë “Vatrën” dhe “Shqipërinë e Lirë”: e para e kundërshtoi emërimin e Laskos, ndërsa e dyta e përkrahu.

Në vitin 1967, tensioni u ul dhe u duk se të dyja grupet po arrinin një kompromis. Madje të dyja organizatat ishin shprehur për kremtimin së bashku të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Misioni i Shqipërisë reagoi menjëherë dhe nxiti njerëzit e tij që të kundërshtonin si kompromisin për Peshkopatën, ashtu edhe marrëveshjen për bashkëpunimin me “Vatrën” në kremtimet e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Misioni trembej se kjo frymë kompromisi mund të çonte në afrimin midis “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë”, prandaj ai iu vu punës që ta pengonte atë. Ndërkohë “Vatra” e thelloi luftën kundër regjimit komunist. Për herë të parë ajo i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të ushtronte presion ndaj qeverisë shqiptare, që ajo të respektonte të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Shkatërrimi i institucioneve fetare në Shqipëri i dha efektet e veta negative edhe në diasporë. Duke përfituar nga situata e favorshme që ishte krijuar, Patrikana e Stambollit dhe kishat greke u riaktivizuan përsëri. Për të neutralizuar presionin dhe ndërhyrjen greke, Peshkopata Shqiptare e Amerikës u bashkua në vitin 1972 me Kishën Ortodokse Lindore Amerikane, e cila drejtohej nga një sinod me peshkop rus.³¹ Ndonëse lidhjet me atdheun u ndërprejnë dhe rreziqet ishin gjithmonë evidente, pavarësia dhe karakteri kombëtar i Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë u ruajt.

Ndryshe ndodhi në Turqi ku zbulimi grek dhe Patrikana Greke i sprapsën përpjekjet e ortodoksëve shqiptarë për çeljen e një kisha dhe shkollë shqipe, si dhe thelluan procesin e konvertimit të shqiptarëve

³¹ *Po aty*, f. 323.

ortodoksë në grekë, duke u akorduar atyre edhe shtetësinë greke.³² Qeveria greke përfitoi nga statusi i paqartë dhe i pafavorshëm i emigracionit ortodoks shqiptar në Turqi nga legjislacioni turk, i cili u ndalonte atyre marrjen e shtetësisë turke, nga izolimi i këtij emigracioni nga Shqipëria për shkak të mungesës së marrëdhënieve diplomatike midis të dyja vendeve dhe, pas vitit 1958, nga politika intransigjente e qeverisë shqiptare. Gjithsesi, me përpjekjet e shumë patriotëve ortodoksë shqiptarë, në vitin 1965 u hap e para kishë ortodokse shqiptare në Stamboll. Kjo alarmoi qeverinë greke dhe Patrikanën e Stambollit e cila, për më tepër, ishte e shqetësuar se, si rezultat i shkëputjes së shqiptarëve, do të humbiste numrin limit të ortodoksëve nën kontrollin e saj dhe, kështu, do të vihej në rrezik edhe statusi dhe qëndrimi i saj në Stamboll.³³ Prandaj ajo intensifikoi presionin mbi komunitetin ortodoks shqiptar. Ajo arriti që ta neutralizonte dhe ta bënte pasive masën e emigrantëve ortodoksë shqiptarë, të cilët u trembën të merrnin në dorë një kishë, e cila ishte bërë “afaros” (ishte mallkuar) nga Patrikana. Në këto momente kritike ndërhyri Federata Panshqiptare “Vatra”, e cila vendosi dërgimin e një prifti nga Amerika dhe i akordoi një ndihmë prej 20 000 dollarësh Kishës Ortodokse Shqiptare të Stambollit. Por këtë iniciativë e pengoi me vendosmëri qeveria komuniste e Tiranës, e cila këmbënguli që prifti të vinte nga Shqipëria dhe të ishte plotësisht nën kontrollin e saj.³⁴ Më tej, ardhjen e priftit nga Tirana e kundërshtoi edhe qeveria turke, e cila ishte e pakënaqur nga propaganda komuniste që po zhvillonte legata shqiptare në Turqi. Kështu krijimi i kishës shqiptare mbeti pezull. Ndërkohë në vitin 1967 në Shqipëri u zhvillua fushata kundër fesë, e cila e dëmtoi edhe më shumë imazhin dhe pozitat e qeverisë komuniste në diasporën shqiptare dhe eliminoi Sinodin e KOASH-it, i cili ishte institucioni më i lartë dhe i rëndësishëm në hierarkinë e kishave ortodokse shqiptare. Gjithashtu në vitin 1969 qeveria shqiptare dërgoi në Stamboll, fshehurazi dhe kundër dëshirës së autoriteteve turke, një prift nga Shqipëria, duke shkaktuar reagimin e tyre. Në këto rrethana konfliktuale, nën presionin e autoriteteve turke dhe të Patrikanës, krijimi i Kishës Ortodokse Shqiptare

³² Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia: 1949-1990 Paqja e vështirë* (Tiranë: Globus R, 2007), 284.

³³ *AMPJ*, V. 1965, D. 585. Radiogram i ambasadës shqiptare në Ankara, drejtuar MPJ-së, Ankara, 11 mars 1965.

³⁴ *Po aty*, V. 1966, D. 362/1. Radiogram i ambasadës shqiptare në Ankara, drejtuar MPJ-së, Ankara, 12 mars 1966.

u sabotua dhe dështoi. Më tej pasoi largimi në masë i emigrantëve ortodoksë shqiptarë për në Greqi dhe asimilimi i tyre.³⁵

Ballafaqimi midis shqiptarëve dhe grekëve u zhvillua edhe në disa koloni të tjera. Konkluzioni i MPJ-së të Shqipërisë ishte se ndryshe nga Jugosllavia, e cila nuk kishte pasur sukses në politikën ndaj emigracionit shqiptar, Greqia “kishte arritur rezultate të gjera” në emigracionin që e kishte origjinën nga minoriteti grek i Shqipërisë dhe në një pjesë të emigracionit shqiptar ortodoks në disa vende të rëndësishme, si SHBA, Argentinë, Republika Arabe e Bashkuar dhe në Australi.³⁶

Grupi më i madh i emigracionit shqiptar ishte i vendosur në Turqi, i cili për nga rëndësia politike dhe aktiviteti i tij renditej i dyti, pas emigracionit shqiptar në Amerikë. Deri në vitin 1952, emigracioni shqiptar nuk ishte i legalizuar. Në këtë kohë, me iniciativën e një grupi emigrantësh politikë, u krijua “Shoqata Turko-Shqiptare”, e cila u bë organizata më e madhe e emigracionit shqiptar në këtë vend. Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Turqinë, qeveria shqiptare filloi t’i kushtojë vëmendje edhe emigracionit në këtë vend, i cili, nga ana e tij, e priti me shpresë vendosjen e marrëdhënieve, sepse mendonte që kjo do të ndikonte në mbrojtjen dhe në përmirësimin e statusit të tij. Por koha tregoi se legata e Shqipërisë nuk bëri asgjë në këtë drejtim. Vëmendjen kryesore legata e përqendroi në goditjen e “Shoqatës Turko-Shqiptare” me qëllim që, fillimisht, ta neutralizonte atë dhe pastaj ta vinte nën kontrollin e saj. Drejtimi tjetër i veprimtarisë së saj ishte lufta propagandistike kundër Ballit Kombëtar dhe grupeve të tjera të emigracionit politik shqiptar, për t’i izoluar ato nga emigracioni kosovar. Nga ana e saj, qeveria turke ushtroi presion mbi shoqatën që të mos pranonte intelektualë kosovarë. Ajo druante se kosovarët do ta përdornin atë si çerdhe të propagandës kundër Jugosllavisë, gjë të cilën Ankaraja nuk e dëshironte. Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Turqi, “Shoqata Turko-Shqiptare” u shpërnda.

“Shoqata Turko-Shqiptare” u krijua përsëri në fillim të viteve ’70, por drejtimi i saj tashmë ra në dorë të njerëzve që ishin të lidhur me legatën e Shqipërisë në Turqi. Legata shqiptare e teproi me ndërhyrjet ndaj shoqatës, duke e kthyer atë në një agjenci propagandistike. Kjo solli

³⁵ Meta, *Shqipëria dhe Greqia: 1949-1990*, 293.

³⁶ AMPJ, V. 1964, D. 14/4. Relacion mbi gjendjen e kolonive shqiptare dhe masat për intesifikimin e punës së tyre, Tiranë, 1966.

kundërveprimin e autoriteteve turke. Si pasojë, shumë anëtarë të shoqatës u larguan prej saj.³⁷

Pas shpërnguljeve të mëdha të shqiptarëve nga Jugosllavia në vitet '50, u shtua ndjeshëm pesha e emigracionit shqiptar në Turqi dhe në vende të tjera. Ky emigracion i madh në numër u vlerësua nga qeveria shqiptare si një rrezik potencial nga ku zbulimet amerikane, jugosllave etj., mund të përgatisnin një forcë të armatosur për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri. Legata e Shqipërisë në Ankara njoftoi Tiranën se kishte zbuluar një përpjekje të Legalitetit për të rekrutuar 5 000 vullnetarë që do të dërgoheshin në Shqipëri kundër regjimit komunist dhe se këtë operacion po e ndihmonin drejtpërdrejt amerikanët. Organet e zbulimit shqiptar e vlerësonin zbulimin amerikan si më aktivin në drejtim të emigracionit kosovar, i cili thuhej se kishte krijuar organizatën “Lidhja e Prizrenit” me elementë me reputacion e veprimtari patriotike e antijugosllave, që po përhapnin e po mbështetnin parullat për çlirimin e Kosovës.

Edhe zbulimi jugosllav ishte shumë aktiv kundrejt emigracionit kosovar në Turqi. Ai po përpiqej ta përdorte atë për të nxitur më tej procesin e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e tyre në Jugosllavi, duke nxitur në forma të ndryshme propagandistike edhe asimilimin dhe turqizimin e kosovarëve. Jugosllavët punonin si për armiqësimin e emigracionit kosovar me qeverinë e Shqipërisë, ashtu edhe me organizatat nacionaliste shqiptare në emigracion.

Në fund të viteve '70, organizatat patriotike kosovare në Perëndim erdhën duke e rritur aktivitetin e tyre. Në krye qëndronin organizatat me orientim antikomunist, si “Lidhja e Prizrenit”, e cila ishte bërë iniciatore e bashkimit të të gjithë emigracionit shqiptar. Përpjekjet për krijimin e organizatës “Lidhja e Prizrenit” filluan në vitin 1962 dhe në dhjetor të këtij viti kjo organizatë shpalli në Nju-Jork programin e saj, i cili shpaloste qëllimin për çlirimin e Kosovës nga sundimi komunist jugosllav dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Nismëtarë të kësaj organizate ishin luftëtarët veteranë: Bajrush Kosova, Destan Berisha, Musa Vuçitërnë, Hysen Tërpeza, Mehmet Agë Rashkoci, Kalosh Hamdia, Isuf Adili, Iljaz Peka dhe i riu energjik Ismet Berisha, të cilët zgjodhën në krye të organizatës Xhafer Devën. “Lidhja e Prizrenit” krijoi degë në

³⁷ *Po aty*, V. 1965, D. 582, fl. 28-30. Relacion i MPJ-së mbi gjendjen e kolonive shqiptare, Tiranë, 1965.

Australi, Siri, Turqi, Belgjikë, Francë, Gjermani, Kanada, SHBA etj. Në Mbledhjen e Madridit, në vitin 1972, Xhaferr Deva u caktua kryetar i Komitetit Provizor për bashkimin e emigracionit shqiptar dhe për krijimin e një “Qeverie Provizore në Mërgim”.³⁸ Një organizatë tjetër e fuqishme ishte “Lidhja Kosovare”, e krijuar në shkurt të vitit 1957 në SHBA. Ajo botonte buletin “Përpjekja kosovare”. “Lidhja” kishte degët e saj në SHBA, Turqi, Francë etj. dhe mbante lidhje të ngushta me Ballin Agrar të Abaz Ermenjit. Në fund të viteve ’70 vepronte edhe një rrjet organizatash të tjera kosovare.

Pas shtypjes së dhunshme të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë dhe fushatës së egër të persekutimit serb që e pasoi atë, u krijua një valë e re emigrimi masiv të qindra mijëra shqiptarëve nga viset shqiptare nën Jugosllavi drejt Perëndimit. Vendi kryesor ku u drejtua ky emigracion ishte Amerika. Vërshimi i këtyre refugjatëve këtu u bë nëpërmjet territorit meksikan e kanadez. Autoritetet jugosllave e inkurajuan në forma dhe mënyra të ndryshme largimin e të rinjve shqiptarë në Perëndim. Ata krijuan lehtësira për marrjen e vizave. Sipas të dhënave të misionit të Shqipërisë në OKB, rezultonte se në vitin 1989 në SHBA e në Kanada kishte 300 000 shqiptarë dhe numri i tyre sa vinte e po shtohej. 90 % e këtyre emigrantëve ishin nga trojet shqiptare në Mal të Zi e Maqedoni dhe pjesa tjetër nga Kosova.

Me ardhjen e tyre, sigurisht dhe nën peshën e ngjarjeve që po ndodhnin në Jugosllavi, politika e PPSH-së ndaj Kosovës ndryshoi. Ajo iu largua politikave të vjetra të kundërshtimit të kërkesave të emigracionit kosovar për çlirimin e Kosovës nga sundimi serb dhe përkrahu, ndonëse jo në mënyrë të hapur, parullën e një pjese të madhe të emigracionit kosovar: “Kosova Republikë”. Gjithashtu, edhe organizatat e reja të emigracionit kosovar që u krijuan pas kësaj vale emigrimi, ajo nuk i konsideroi më si grupime armiqësore, por u përpoq të shtrinte ndikimin e vet mbi to.

Në vitet ’80 krijimi i klubeve e shoqërive të reja kosovare në Perëndim mori një hov të madh. Ato, pothuajse të gjitha, u vunë në mbështetje të demonstratave të vitit 1981 dhe përkrahën krijimin e Republikës së Kosovës. Organizata më e konsoliduar ishte Klubi Kombëtar “Jusuf Gërvalla” me qendër në Bronks të Nju-Jorkut, i krijuar

³⁸ Idriz Lamaj, *Xhaferr Deva nën dritën e letrave të veta dhe zbulesa të tjera të mërgatës* (New York: 2002), 115-118.

në vitin 1983 me 200 anëtarë. Ky grup kishte një përkrahje të gjerë në emigracionin kosovar. Ai kishte krijuar dhe drejtonte shoqërinë kulturore “Ded Gjon Luli”, klubin sportiv “Kosova 81”, radion “Zëri i Malësisë” dhe një shkollë shqipe me 40 nxënës. Grupi organizonte demonstrata, protesta, greva urie, mbledhje e veprimtari të ndryshme në përkrahje të përpjekjeve për Kosovën Republikë. Ai mbante lidhje të ngushta me Misionin e Shqipërisë në OKB dhe mbështeste pa rezerva politikën e qeverisë së Shqipërisë. Pas tij vinte shoqëria “Shqiptari” me qendër në Detroit, e krijuar në vitin 1984, e cila kishte fizionomi të ngjashme me klubin “Jusuf Gërvalla”. Më tej renditeshin klubi “Shpresa” me qendër në Bruklin të Nju-Jorkut, që kishte lidhje me grupet kosovare në Europë; Fondi i Përbashkët i Shqiptarëve Struganë, i krijuar në vitin 1977, Shoqata Kosovare e Torontos, organizata “Atdheu” me qendër në Detroit, Shoqata Kosovare e Dallasit etj., të cilat që të gjitha përkrahnin devizën: Kosova-Republikë.

Ekzistenca e kaq shumë organizatave pengonte bashkimin e emigracionit shqiptar në një organizatë të vetme e të fuqishme, e cila do të ishte efektive në luftën për çlirimin e Kosovës. Këtu ndikonin një sërë faktorësh, si paaftësia e krerëve të emigracionit kosovar; veprimtaria përçarëse e qeverisë jugosllave; dobësitë e punës së misioneve diplomatike të qeverisë shqiptare në Perëndim, që i penguan ato të bëheshin organizatore e katalizatore të bashkimit.

Me gjithë përpjekjet penguese të qeverisë së Tiranës, partitë dhe grupimet e vjetra të emigracionit politik, si Legaliteti, Blloku Kombëtar Independent, Balli Kombëtar, “Lidhja Kosovare”, arritën të influenconin ndjeshëm emigracionin e ri. Strategjia e tyre ishte që luftën për çlirimin e Kosovës ta lidhnin me përpjekjet për përmbysjen e regjimit komunist në Shqipëri dhe për demokratizimin e saj. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare konstatonte rritjen e përkrahjes amerikane për emigracionin kosovar. Për këto arsye, ajo udhëzoi përfaqësitë e saj që të bënin kujdes për të mbajtur nën kontroll emigracionin e ri kosovar. Vëmendja kryesore u përqendrua te Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane (Lobi Shqiptaro-Amerikan), me synimin që orientimi i saj të mbetej brenda kornizave të politikës së qeverisë shqiptare për Kosovën dhe për zhvillimet në Shqipëri.³⁹

³⁹ AMPJ, V. 1955, D. 401, fl. 34-35. Raport i legatës shqiptare në Paris, drejtuar MPJ-së, lidhur me aktivitetin e emigracionit politik shqiptar, Paris, 25 maj 1955.

Por ngjarjet në Europën Lindore dhe rënia e regjimeve komuniste e thelluan krizën politike edhe në Shqipëri. Në rrethana të tilla do të rritej edhe aktiviteti e presioni i emigracionit shqiptar kundër regjimit komunist, duke kërkuar përmbysjen e tij.

Emigracioni politik

Në emigracionin politik përfshiheshin kundërshtarë politikë të qeverisë komuniste që kishin emigruar për t'iu shpëtuar përndjekjeve të regjimit në përfundim dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e emigrantëve politikë, por Ministria e Jashtme e Shqipërisë në vitin 1975 e llogariste atë në 10-12 mijë veta. Ndonëse nuk ishin të shumtë në numër, këta emigrantë përbënin elitën politike dhe intelektuale të vendit që ishte formuar deri në këtë kohë dhe njëkohësisht opozitën antikomuniste, e cila, në përgjithësi, ishte e orientuar nga fuqitë perëndimore.

Gjatë vitit 1945 vazhdoi procesi i riorganizimit të partive të vjetra antikomuniste, Balli Kombëtar dhe Legaliteti dhe, njëkohësisht, po bëheshin përpjekje për krijimin e grupeve të reja. Më 31 dhjetor 1945 në Rexhio Emilia të Italisë u zhvillua Kongresi i Dytë i Ballit Kombëtar. Në qendër të programit të miratuar aty u vu lufta kundër komunizmit. Në këtë kongres u miratua statuti, dekallogu, një dokument me titull “Tetë Pikat e Nacionalizmit Shqiptar”, si dhe “Parimet Politike”. Balli Kombëtar i dërgoi Konferencës së Paqes një memorandum të nënshkruar nga Mit’hat Frashëri, Lec Kurti dhe Vasil Andoni, në të cilin atakoheshin një e nga një argumentet e politikës aneksioniste greke kundrejt Shqipërisë. Memorandumi u paraqit në emër të emigracionit dhe popullit shqiptar i cili, pavarësisht sundimit të regjimit komunist, nuk e kishte humbur besimin dhe simpatinë për aleatët perëndimorë. Konferencës i kërkohesh që të mos e linte pavarësinë dhe ekzistencën e Shqipërisë në një gjendje simulimi, por të shndërroheshin ato në një realitet të qëndrueshëm. Për këtë qëllim asaj duhej t’i bashkoheshin trevat e rëndësishme shqiptare të aneksuara nga fqinjët.⁴⁰

⁴⁰ *Po aty*, V. 1953, D. 266, fl. 14-15. Letër e të Ngarkuarit me Punë në Itali Skënder Konica, drejtuar MPJ-së, lidhur me gjendjen e emigracionit politik, Romë, 22 maj 1953.

Në vitin 1946 në Itali u krijua edhe organizata Blloku Kombëtar Independent, në radhët e së cilës aderuan mjaft emigrantë që kishin marrë pjesë në qeveritë dhe administratën shqiptare nën pushtimin nazifashist. Ernest Koliqi konsiderohej si timonieri dhe ideatori i kësaj organizate.⁴¹ Pas tij u krijua edhe grupi Demo-Laburist i kryesuar nga Ibrahim Farka, Seit Kryeziu dhe Ihsan Toptani. Ekzistonte edhe grupi i kosovarëve që drejtohej nga Xhaferr Deva. Në mërgim ekzistonte edhe një grup tjetër nacionalistësh shqiptarë, të cilët nuk ishin përzier në ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Personaliteti më i shquar ishte Mehmet Konica, i cili gjatë luftës nuk kishte pranuar ofertën e gjermanëve për t'u bërë ministër i Jashtëm i Shqipërisë. Ai kishte marrëdhënie të ngushta me amerikanët dhe britanikët, të cilët konsultoheshin gjerësisht me të për problemet e Shqipërisë. Në vitin 1945, M. Konica kishte propozuar formimin në Shqipëri të një qeverie demokratike me bazë të gjerë dhe me elementë që kishin qëndruar jashtë konfliktit civil në Shqipëri.⁴²

Në vitin 1948 u shtrua realisht çështja e bashkimit të grupeve të emigracionit politik, e cila u nxit edhe nga konflikti që shpërtheu midis PKSH-së e PKJ-së. Në këtë kohë SHBA-ja e Britania e Madhe, ashtu si dhe Italia e Greqia, ndërhyjnë që emigracioni politik të bashkohej në një organizëm të vetëm. Qeveria greke në vitin 1948 dërgoi në Itali Vangjel Qirkon, i cili bisedoi me krerët e Ballit Kombëtar dhe Bllokut Independent. Ai u premtoi atyre se Athina do të ndihmonte për të ndryshuar situatën në Shqipëri dhe propozoi një bashkim vullnetar të të dyja shteteve. Por misioni i tij nuk pati sukses, pasi krerët e emigracionit politik shqiptar nuk pranuan të angazhonin veten në ndonjë veprimtari me Greqinë, përderisa kjo nuk kishte hequr dorë nga pretendimet për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Përpyekjet për bashkim ndeshën në vështirësi edhe brenda grupeve, të cilat kishin midis tyre divergjenca e opinione të ndryshme mbi mënyrën e organizimit të luftës kundër regjimit komunist në Shqipëri dhe për formën e regjimit që duhej vendosur atje pas përmbysjes së tij.

Balli Kombëtar e pranonte parimisht bashkimin, por ishte shumë intolerant kur ishte fjala për principet mbi të cilat do të arrihej ai. Pjesa

⁴¹ *Po aty*, fl. 23-24. Letër e të Ngarkuarit me Punë në Itali Skënder Konica, drejtuar MPJ-së, lidhur me aktivitetin e emigracionit politik dhe përkrahjen e tij nga qeveria italiane, Romë, 22 shkurt 1953.

⁴² *Po aty*, V. 1955, D. 401, fl. 47-50. Raport i legatës shqiptare në Paris, drejtuar MPJ-së, lidhur me aktivitetin e emigracionit politik shqiptar, Paris, 1955.

më e madhe, kryesisht elementi i ri i Ballit, ishte kundër bashkimit me Bllokun Indipendent, pa larguar më parë prej tij ata elementë që kishin bashkëpunuar me italianët gjatë pushtimit. Korrenti i Mit'hat Frashërit kishte marrëdhënie jo të mira edhe me monarkistët, për arsye se ai dhe pasuesit e tij ishin republikanë të vendosur dhe nuk e dëshironin kthimin e monarkisë në Shqipëri.⁴³ Për këtë arsye, ky korrent u quajt grupi i ekstremistëve. Brenda Ballit ekzistonte edhe një grup tjetër moderator, por ai kishte një influencë më të vogël. Qëndrimi i Ballit ndaj projekteve për bashkimin e emigracionit politik ishte i rëndësishëm, sepse ai përbënte forcën më të madhe dhe më me influencë në emigracionin shqiptar. Balli kishte shumicën në emigracionin politik në Itali, Angli, Australi, SHBA e Kanada. Ndërsa Legaliteti kishte më shumë influencë në emigracionin politik në Greqi, Turqi, Egjipt etj.

Nën kujdesin e Ballit botoheshin disa organe shtypi, si “Flamuri”, “Albania” në Itali, “Shërbestari i Shqipërisë” në SHBA dhe një buletin lajmesh nga Shqipëria me titullin “Lettere D’Albania”. Gazeta “Flamuri”, që ishte organ zyrtar i partisë, ishte njëra nga gazetatat më të mëdha të emigracionit shqiptar dhe botohej në 6 000 ekzemplarë.⁴⁴

Legaliteti përbëhej nga dy korrente: A. Zogu me të vjetrit, si H. Delvina, M. Juka etj. dhe A. Kupi me të rinjtë. A. Zogu gjithmonë kishte shprehur dëshirën për bashkëpunim me Ballin Kombëtar, por pa hequr dorë nga programi i tij për t’u rikthyer si Mbret i Shqipërisë.

Në maj të vitit 1948, Mit'hat Frashëri parashtoi platformën për bashkimin e emigracionit. Përpyekjet serioze për bashkimin filluan në prill të vitit 1949. Iniciativa dhe nxitja e re e kësaj lëvizjeje erdhi nga amerikanët e britanikët nëpërmjet Komitetit “Evropa e Lirë”. Në bisedimet e zhvilluara në periudhën prill-gusht 1949 nga Balli Kombëtar morën pjesë Mit'hat Frashëri, Abaz Ermenji, Hasan Dosti e Zef Pali, kurse nga Legaliteti, Abaz Kupi e Selim Dumani, si dhe Seit Kryeziu i pavarur. Bisedimet ishin të vështira dhe marrëveshja u arrit pasi u kapërcyen disa mosmarrëveshje për përbërjen e komitetit që do të krijohet dhe për formën e regjimit, për të cilën u arrit kompromisi që ajo

⁴³ *Po aty*, V. 1953, D. 266, fl. 23-24. Letër e të Ngarkuarit me Punë në Itali Skënder Konica, drejtuar MPJ-së, lidhur me aktivitetin e emigracionit politik, Romë, 18 tetor 1953.

⁴⁴ *Po aty*, V. 1952, D. 184/1, fl. 18. Letër e të Ngarkuarit me Punë në Itali Skënder Konica, drejtuar MPJ-së, lidhur me shtypin e organizatave antikomuniste, Romë, 26 mars 1952.

të caktohej nga populli shqiptar me votim të lirë. Krijimi i Komitetit Kombëtar “Shqipëria e Lirë” (KKSHL) u shpall më 26 gusht 1949. KKSHL-ja drejtohej nga një komitet ekzekutiv nën kryesinë e Mit’hat Frashërit. Anëtarë të tij ishin Abaz Kupi, Said Kryeziu, Zef Pali dhe Nuçi Kota. Përveç Komitetit Ekzekutiv funksiononte edhe Komiteti i Përgjithshëm Konsultativ, i cili ishte më i gjerë. Blloku Independent mbeti jashtë Komitetit “Shqipëria e Lirë”. Në deklaratën e miratuar në Londër në shtator të vitit 1949 theksohej se qëllimi i KKSHL-së ishte lufta për të fituar pavarësinë e Shqipërisë dhe për të siguruar sovranitetin e integritetin e saj. Pas përmbyesjes së regjimit komunist, popullit shqiptar do t’i jepej mundësia të caktonte nëpërmjet zgjedhjeve të lira formën e regjimit dhe të krijonte një qeveri demokratike, e cila do t’i garantonte liritë politike dhe të drejtat njerëzore.⁴⁵

Gjendja ekonomike, sociale dhe shpirtërore e emigracionit politik shqiptar ishte e rëndë, por gjithashtu ajo kishte edhe diferenca. Ajo ishte më e mirë në SHBA dhe në disa vende të tjera perëndimore, por ishte e rëndë veçanërisht në vendet fqinje, në Greqi dhe Jugosllavi. Në këto dy vende emigrantët politikë nacionalistë u keqtrajtuuan dhe vuajtën shumë presionet e këtyre qeverive. Gjithashtu në këto vende, sidomos në Greqi, gjendej një numër i konsiderueshëm emigrantësh politikë me prirje grekomane që vetëquheshin “vorio-epirotë” apo sllavofilë, të cilët iu kundërvunë emigracionit politik shqiptar dhe përkrahën politikat nacionaliste të këtyre shteteve kundrejt Shqipërisë. Nga ana tjetër, duhet theksuar se marrëdhëniet e emigracionit antikomunist nacionalist shqiptar që përfaqësohej nga KKSHL-ja me qeveritë greke dhe jugosllave mbetën të ftohta dhe gati armiqësore. Arsyeja kryesore ishte shqetësimi i udhëheqësve të emigracionit politik shqiptar ndaj synimeve aneksioniste të politikës greke dhe jugosllave, si dhe qëndrimit të këtyre dy shteteve kundrejt shqiptarëve që gjendeshin nën sundimin e tyre.⁴⁶

Krijimi i KKSHL-së e fuqizoi aktivitetin antikomunist të emigracionit politik. Përveç propagandës, KKSHL-ja u angazhua edhe në aksionin e parë që ndërmorën fuqitë perëndimore për përmbyesjen e regjimit stalinist të Shqipërisë. Operacioni që u zhvillua në vitet 1949-1953 synonte ta çlironte Shqipërinë nga zgjedha komuniste e të vendoste

⁴⁵ Rexhep Krasniqi, *Komiteti Shqipëria e Lirë dhe stalinizmi në Shqipëri* (Tiranë: Dardania, 2001), 13-14.

⁴⁶ Meta, *Shqipëria dhe Greqia: 1949-1990*, 306-309.

aty një regjim properëndimor.⁴⁷ Por kjo tentativë dështoi. Arsyet kryesore ishin kontrolli i fortë që ushtronte regjimi në Shqipëri dhe tradhtia e agjentit të dyfishtë britanik, Kim Filbi, i cili i dha KGB-së të gjithë planin dhe detajet e operacionit. Përveç këtyre arsyeve edhe këmbëngulja e disa shteteve fqinje për të realizuar projektet e tyre në kurriz të Shqipërisë, e penguan KKSHL-në të arrinte synimet në luftën kundër regjimit komunist. Athina dhe Beogradi, pasi nuk mundën t'u impononin organizatave nacionaliste antikomuniste shqiptare agjendat e tyre politike, mbajtën një qëndrim bllokues kundrejt aktiviteteve antikomuniste të KKSHL-së. Politika e KKSHL-së dhe e organizatave nacionaliste antikomuniste shqiptare gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë vijoi të mbështetej në tri shtylla kryesore: në përpjekjet për çlirimin e Shqipërisë nga regjimi komunist dhe vendosjen e një regjimi demokratik properëndimor; në përpjekjet për sigurimin dhe ruajtjen e pavarësisë dhe të integritetit territorial të Shqipërisë; si dhe në përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që ishin nën sundimin e vendeve fqinje dhe për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet kombëtar. Mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi dhe denoncimi i tragjedisë së shqiptarëve të Çamërisë nga emigracioni shqiptar, si ai ekonomik ashtu edhe ai politik, pati një rëndësi të veçantë, pasi ata ishin zëri i vetëm në Perëndim dhe në arenën ndërkombëtare, sepse qeveria komuniste, e vetizoluar politikisht, i kishte braktisur në një harresë të plotë këto çështje madhore. Veçanërisht qëndrimet e emigracionit politik shqiptar kishin rëndësi të veçantë, pasi fuqitë perëndimore shihnin te përfaqësuesit e tij bërthamën e qeverisë së ardhshme postkomuniste shqiptare.⁴⁸

Por midis këtyre organizatave vijuan edhe divergjencat për çështje të ndryshme politike. Kështu, qysh pas krijimit të KKSHL-së, u thelluan përçarjet brenda Ballit Kombëtar. Në vitin 1950, Ali Këlcyra shpalli formimin e partisë së vërtetë demokratike Balli Kombëtar. Divergjencat ishin sa personale, aq edhe politike. Pjesa tjetër e Ballit e denoncoi A. Këlcyrën se kishte përkrahur agresionin fashist të 7 prillit 1939. Pas

⁴⁷ *AMPJ*, V. 1955, D. 397, fl. 54-55. Raport i Sigurimit të Shtetit “Ndërhyrja dhe nxitja nga ana e amerikanëve e emigracionit reaksionar shqiptar për aktivizimin kundra nesh”, drejtuar MPJ-së, Tiranë, 1955.

⁴⁸ *Po aty*, V. 1955, D. 421, fl. 27-30. Raport i Sigurimit të Shtetit, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Behar Shtylla, “Mbi gjendjen dhe aktivitetin e emigracionit reaksionar shqiptar në vendet kapitaliste”, Tiranë, 12 korrik 1955.

vdekjes së M. Frashërit në tetor të vitit 1949, Balli Kombëtar u gjend në vështirësi për ta zëvendësuar atë. Hasan Dosti që zuri vendin e tij u pranua me vështirësi si kryetar i KKSHL-së nga grupet e tjera. Në këtë mënyrë, ndarjet midis tyre mbetën edhe më tutje.⁴⁹

Pas dështimit të operacionit për përmbysjen e regjimit komunist në Shqipëri në vitet 1949-1953, amerikanët nxitën riorganizimin e KKSHL-së, me qëllim që ta bënin atë me përfaqësues edhe më efektiv dhe të kapërcenin përçarjet që ekzistonin në grupet e ndryshme të emigracionit. Riorganizimi u shpall në tetor të vitit 1953. Komiteti i ri që kryesohej sërish nga Hasan Dosti, tani përfshinte edhe krerë të Bllokut Independent, si dhe individë të tjerë të njohur e me influencë në emigracion. Mirëpo, riorganizimi i KKSHL-së provokoi një çarje tjetër në Partinë Demokratike Agrare Shqiptare (PDASH) - Balli Kombëtar, midis një fraksioni të vogël të kryesuar nga H. Dosti, që pranoi formulën e re për riorganizimin e KKSHL-së dhe pjesës tjetër të Ballit të kryesuar nga Vasil Andoni, Abaz Ermenji etj., të cilët kundërshtonin përfshirjen në komitetin e riorganizuar të elementëve të komprometuar të Bllokut Independent, anulimin e statutit të komitetit që drejtohej nga M. Frashëri dhe anulimin e Deklaratës Politike të Londrës të shtatorit 1949.⁵⁰ Në një letër dërguar Departamentit të Shtetit, krerët e Ballit e konsideronin rikonstruktimin e imponuar të KKSHL-së dhe imponimin e kushtetutës dhe të rregulloreve të tij si veprime të paarsyeshme, të pafrytshme e të padëshirueshme për shqiptarët. Qëndrim kritik ndaj mënyrës së organizimit të komitetit të ri mbajtën edhe Abaz Kupi e Seit Kryeziu. Në këtë mënyrë, organizimi i ri nuk i arriti objektivat e veta dhe nuk mundi të eliminojë përçarjen midis grupeve rivale.⁵¹

Partia e Ballit Kombëtar e kryesuar nga V. Andoni dhe A. Ermenji qëndruan jashtë KKSHL-së dhe më vonë, më 12 gusht të vitit 1954, ata formuan në Paris një komitet tjetër që e pagëzuan me emrin Komiteti Kombëtar Demokrat “Shqipëria e Lirë” (KKDSHL). Në këtë komitet u përfshinë përveç Ballit Kombëtar Agrar edhe grupi “Besa” i Turqisë,

⁴⁹ Raport i Ballit Kombëtar në Kongresin VI të Bashkimit Ndërkombëtar të Katundarëve në Washington, *Flamuri*, nr. 109-112 (New York: 28 nëntor 1959).

⁵⁰ *AMPJ*, V. 1955, D. 396, fl. 11-17. Relacion i ministrit shqiptar në Francë, Ulvi Lulo, drejtuar MPJ-së, lidhur me gjendjen e kolonisë shqiptare në Francë-Argjentinë-Amerikë-Australi në gjysmën e parë të vitit 1955, Paris, 1955.

⁵¹ *Po aty*, fl. 47-55. Raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtuar Enver Hoxhës, lidhur me gjendjen e emigracionit shqiptar në vendet kapitaliste, Tiranë, 6 janar 1955.

Liberalët e Londrës, si dhe disa shqiptarë nga kolonitë e Amerikës. Midis të dyja komiteteve vijuan polemikat.

Në pranverë të vitit 1956 KKSHL u shpërnda. Më pas fuqitë perëndimore mbështetën idenë e krijimit të një “Komiteti Pune” me njerëz jashtë grupeve politike, që do të ishin nëpunës të emëruar nga Komiteti “Evropa e Lirë”. Komiteti u krijua në nëntor të vitit 1956 dhe në krye të tij u vu Rexhep Krasniqi, por ai nuk pati mbështetjen e krerëve kryesorë të emigracionit. Në këtë mënyrë aktiviteti i komitetit nisi të bjerë.⁵² Në këtë proces pati ndikimin e vet edhe evoluimi i situatës ndërkombëtare, veçanërisht periudha e Detantës midis të dyja blloqeve në vitet 1960-1970. Megjithatë komiteti funksionoi deri në vitin 1991.

Ndërkohë u dukën çarje të reja në organizatat politike të emigracionit. Legaliteti u nda në dy fraksione që kryesoheshin nga A. Kupi e G. Goga. Kurse Balli i H. Dostit ishte në konflikt me Ballin e V. Andonit e A. Ermenjit. Këta të fundit, në vitin 1954, arritën të përjashtonin H. Dostin nga Internacionalja Agrare. Balli Kombëtar i A. Ermenjit vendosi lidhje të ngushta me organizatat politike të emigracionit kosovar, si “Lidhja Kosovare” dhe ndihmoi në botimin e periodikëve “Bashkimi i Kosovarëve” dhe “Përpjekja Kosovare” që dilnin në Paris. Si KKSHL, ashtu edhe KKDSHL, u angazhuan gjerësisht në rrugë propagandistike e diplomatike për të frenuar shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre në Jugosllavi. Më 15 mars 1956, A. Ermenji u dërgoi një telegram OKB-së dhe ministrave të Jashtëm të SHBA-së, Anglisë e Francës lidhur me shpërnguljet dhe operacionin e mbledhjes së armëve që kishte ndërmarrë qeveria jugosllave në viset shqiptare, i cili synonte t’i shtrëngonte shqiptarët të emigronin.⁵³

Veç SHBA-së, në vitet ’60-’80 përqendrimet mëdha të emigracionit politik pati në Belgjikë dhe në Francë. Në fillim të viteve ’80 numri i përgjithshëm i emigrantëve politikë në këto vende arrinte në 5 000 veta. Emigracioni politik nga Shqipëria ishte grumbulluar në tri organizatat kryesore politike: Balli Agrar, Legaliteti e Blloku Independent. Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, veprimtaria e

⁵² *Po aty*, V. 1955, D. 421, fl. 44-50. Raport i Sigurimit të Shtetit, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Behar Shtylla, “Mbi gjendjen dhe aktivitetin e emigracionit reaksionar shqiptar në vendet kapitaliste”, Tiranë, 12 korrik 1955.

⁵³ *Po aty*, V. 1955, D. 396, fl. 11-17. Relacion i ministrit shqiptar në Francë, Ulvi Lulo, drejtuar MPJ-së, lidhur me gjendjen e kolonisë shqiptare në Francë-Argjentinë-Amerikë-Australi në gjysmën e dytë të vitit 1955, Paris, 1955.

këtyre organizatave mori një impuls të ri. U intensifikua gjithashtu edhe propaganda kundër regjimit komunist në Shqipëri dhe u hodh parulla “se tani kishte ardhur momenti për rrëzimin e tij”. Po në këtë kuadër, u denoncua politika pasive e qeverisë së Tiranës ndaj çështjes së Kosovës dhe u propagandua teza se çështja e Kosovës do të zgjidhej vetëm me krijimin e Shqipërisë etnike. Në fund të viteve ’80, emigracioni politik shqiptar e rriti presionin ndaj regjimit komunist, duke kërkuar ndryshime të menjëhershme në vend.

Ndërkohë qeveria komuniste ndiqte me vëmendje aktivitetin e emigracionit politik dhe brenda mundësive të saj mori masa për të neutralizuar efektin e tyre. Pasi dështuan përpjekjet për ta vënë nën ndikimin e vet emigracionin politik, Tirana zyrtare e përqendroi vëmendjen në hetimin e lëvizjeve dhe të aktiviteteve të tij, duke marrë njëkohësisht masat për shuarjen e efektit të tyre dhe për diskreditimin e goditjen edhe të elementëve më aktivë në radhët e emigracionit politik.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (AMPJ)

Autoriteti për Informim i Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)

Botime dokumentare:

Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi (dokumente). Përgatiti për botim Hakif Bajrami. Prishtinë: 1996.

Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1945-1958 (dokumente historike). Përgatitën për botim Beqir Meta & Hasan Bello, vëll.II. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2022.

Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1959-1971 (dokumente historike). Përgatitën për botim Beqir Meta & Hasan Bello, vëll.III. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2022.

Mbreti Zog dhe Fan Nolin në dosjet e Sigurimit të Shtetit. Përgatiti për botim Hasan Bello. Tiranë: ASA-Instituti i Historisë, 2021.

Literaturë historiografike:

Meta, Beqir. *Shqipëria dhe Greqia: 1949-1990 Paqja e vështirë*. Tiranë: Globus R, 2007.

Meta, Beqir & E. Dervishi, H. Bello, *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1912-1990*. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2022.

Lamaj, Idriz. *Xhafer Deva nën dritën e letrave të veta dhe zbulesa të tjera të mërgatës*. New York: 2002.

Krasniqi, Rexhep. *Komiteti Shqipëria e Lirë dhe stalinizmi në Shqipëri*. Tiranë: Dardania, 2001.

Gazeta e revista:

Flamuri, New York, 1959.

BEQIR META

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania
beqirmeta@hotmail.com

HASAN BELLO

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania
hasanbello1@gmail.com

S u m m a r y

ALBANIAN EMIGRATION AFTER WORLD WAR II

In this article, the activity of Albanian economic and political emigration after the Second World War is treated on the basis of archival sources. It brings a new perspective on the organization of Albanian political parties and groups in the USA, Europe, Turkey, etc. and the effort they made in cooperation with Western countries to overthrow the communist regime. But on the other hand, this article also analyzes the policy of the government and diplomacy of the communist regime for the control and instrumentalization of Albanian immigration.

